



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK**

Nr. _____ prot.

Tiranë më _____.2021

Lënda: Raport i monitorimit mbi performancën e produkteve/shpenzimeve për vitin 2021

Në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Udhëzimit nr.9 datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit plotësues nr.4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, Zyra e Komisionerit, me anë të këtij relacioni/raporti saktësojmë informacionin mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe performancën e produkteve të realizuara për periudhën vjetore 2021 të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (këtej e tutje “Zyra e Komisionerit” ose KDIMDP).

Monitorimi është një proces vlerësimi performance, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

Vizioni i punës së Zyrës së Komisionerit, është garantimi i zbatimit të rregullave të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Misioni i saj është garantimi i aksesit në informacion të qytetarëve ndaj autoriteteve publike, njohjes së publikut me informacionin publik, si dhe përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në veçanti, të drejtën për informim dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.

Për përmbushjen e sa më sipër, gjatë vitit 2021 dhe në vijim objektivat e Zyrës së Komisionerit do të jenë:

- Mbështetja dhe monitorimi i autoriteteve publike lidhur me vënien në zbatim të Programit të Transparencës së rishikuar dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve;
- Rritja e ndërgjegjësimit të koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe nëpunësve të administratës shtetërore për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe përdorimin e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve;
- Shtrirja e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve në të gjitha autoritetet publike;
- Ndërmarrja e hapave institucionale dhe ligjorë, me autoritetet përkatëse, në lidhje me adresimin e plotë të kërkesave të pikës 1 të nenit 14 të ligjit për të drejtën e informimit,

(trajtimi i kërkesave dhe ankesave për informacion nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania).

- Vijimi i mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga kontrolluesit publik dhe privat të sektorëve të veçantë me risk të lartë, duke përgatitur rekomandime unifikues për fushat specifike, për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, të diktuar veçanërisht nga situata e shkaktuar nga përhapja e pandemisë COVID-19;
- Monitorimi dhe mbikëqyrja e respektimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga subjektet kontrolluese që ushtrojnë veprimtari tregtimi të drejtpërdrejtë.
- Bashkërendimin institucional me kontrolluesit publik për të vijuar mbikëqyrjen dhe monitorimin në funksion të rikuperimit të problematikave të konstatuara në raportin e Zyrës së Komisionerit për mbikëqyrjen e kontrolluesve me fokus platformat *online*, sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe kontrolluesit publik dhe privat të sektorit të kujdesit shëndetësor;
- Vijimin e kontributit në përafrimin e legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës të BE, konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën e Policisë 2016/680 (realizimin me sukses të projektit të binjakëzimit që po asiston Zyrën e Komisionerit në këtë kuadër për vitin 2021) duke zbatuar përtej vitit 2021, detyrimet që rrjedhin nga ndryshimi i legjislacionit në këtë fushë.
- Intensifikimi i dhënies së kontributit dhe angazhimit aktiv në grupet ndërkombëtare të punës, në kuadër të Asamblesë Globale të Privatësisë (GPA), Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) dhe Konferencës Evropiane të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (ECDPA);
- Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere, trajnuese dhe promovuese për fushat e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit me qëllim ushtrimin në praktikë të të drejtave të qytetarëve, me fokus nxënësit e arsimit parauniversitar, studentëve, apo përfaqësues të komuniteteve minoritare etnike/kulturore.
- Marrja e masave konkrete në lidhje me thirrjet e pa kërkuara telefonike ose dërgimit të mesazheve me postë elektronike;
- Forcimi i rolit dhe kapaciteteve të koordinatorit të të drejtës për informim;
- Ngritja e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit në kuadër të harmonizimit të ligjit me *acquis* komunitare;

Në përdorimin e fondeve buxhetore, Zyra e Komisionerit është mbështetur në parimet e menaxhimit dhe mirëfunksionimit të sistemit buxhetor. Edhe këtë vit, disa nga shpenzimet janë lidhur edhe me përshtatjen me kushtet e reja me prezencën e pandemisë botërore të Covid-19, por edhe respektimit të masave anti-covid që lidhen kryesisht me distancimin social, me punën online etj, sipas protokolleve dhe instruksioneve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Për shkak të vijueshmërisë së situatës së pandemisë por edhe realizimit dhe finalizimit të procedurave të prokurimit u ndërmorën masa shtesë, duke rishikuar me prioritet dhe orientuar

shpenzimet buxhetore drejt aktiviteteve kryesore të institucionit, në respektim të parimeve dhe rregullave të menaxhimit financiar.

Në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19, Zyra e Komisionerit, ka orientuar gjatë detajimit të buxhetit në shpenzime të dedikuara në aktivitetet më imediate dhe efikente, me synim përdorimin efektiv të burimeve, përgjegjësi të qarta për realizimin e produktit/nënprodukteve, në funksion të realizimit të objektivave për vitin 2021.

Ndikim në veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit ka patur edhe situata e zgjedhjeve, ku Zyra jonë ka patur angazhimin maksimal në mbikëqyrjen dhe monitorimin e shkeljeve të privatësisë, por në të njëjtën kohë edhe të transparencës së autoriteteve publike dhe sjelljes së tyre, në zbatimin e legjislacionit në fushën tonë të përgjegjësisë.

Për këtë arsye është reduktuar aktiviteti kryesor (inspektime, aktivitete të tjera në terren), për të cilën u rishikua edhe niveli i planifikuar i produktit/nënprodukteve, në rreth 1290 veprime nga 1400 për tu realizuar, me tendencë në rritje.

Në këtë këndvështrim, fondet e vitit 2021 janë reduktuar, si fonde të papërdorura, duke i kaluar në fondet e buxhetit të shtetit. Këto fonde rezervë janë krijuar për arsyet e rënditura më poshtë:

- Ndjekjes së procesit të ristrukturimit i cili si rezultat i afateve të përcaktuara në zbatim të legjislacionit të shërbimit civil, kushtëzoi edhe nisjen e procedurave të rekrutimit;
- Vonesave të plotësimit të strukturës aktuale, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, janar-prill 2021, e cila solli disa kufizimeve të parashikuara në legjislacionin zgjedhor që i përkisnin kësaj periudhe;
- Rishpalljes në mënyrë të përsëritur të procedurave të rekrutimit;
- Largimit të disa nëpunësve gjatë vitit 2021;
- Rezervave të krijuara si rezultat i efekteve pozitive nga procedurat e prokurimit;
- Kufizimit të një pjese të aktiviteteve brenda vendit dhe kryesisht ata jashtë vendit, për shkak të vijimit të situatës së pandemisë edhe gjatë këtij viti duke sjell organizimin e takimeve nëpërmjet platformave online. Për sa vijon sqarojmë se, shpenzimet për udhëtime e dieta jashtë vendit zënë rreth 30% të kategorisë “Shpenzime operative” të Zyrës së Komisionerit.
- Gjetjes së mënyrave alternative për mbulimin financiar të disa aktiviteteve me donatorët vendas.

Vlen të theksohet se edhe këtë vit, Zyra e Komisionerit për përgatitjen e PBA 2022-2024 nuk u përfshi në procesin e hedhjes së të dhënave në AFMIS e për rrjedhojë edhe në plotësimin e modulit të monitorimit duke filluar nga viti 2020 e më pas edhe gjatë këtij raportimi, ku arsyet janë berë të ditura edhe në raportimet periodike parardhëse. Ende nuk ka një ecuri pozitive për zgjidhjen teknike dhe për rrjedhojë edhe kontributin dhe përfshirjen e Zyrës së Komisionerit në këtë sistem të qëndëruar.

Produkti i vetëm i Programit 0110, është **Mbikëqyrje/inspektime të kryera & ankesa të trajtuara**, ku parashikimi (i ndryshuar) është nr.1000 veprime.

E drejta e informimit :

➤ Autoritetet Publike me programe dhe transparencë të plotë

Sigurimi i Transparencës së veprimtarisë së Autoriteteve Publike, nëpërmjet realizimit të proceseve të monitorimit/mbikëqyrjes së elementëve të ndryshëm të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, të autoriteteve publike, të cilat kanë hartuar dhe/ose përditësuar programin e transparencës, forcimin e rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit, përditësimi në regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve, shqyrtimin e ankesave, kryerjen e hetimeve administrative, seancave dëgjimore dhe dhënien e rekomandimeve e vendimeve.

➤ Trajtim i ankesave brenda afateve dhe (kthim përgjigje/inspektime/vendime, kryesisht në bazë të ankesave).

Ankesa të trajtuara në kuadër të parashikimeve të Ligjit “Për të Drejtën e Informimit” si dhe Ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, hetime të kryera, seanca dëgjimore të zhvilluara si dhe vendime të dhëna, duke rritur në këtë mënyrë kontrollin mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion.

Mbrojtja e të dhënave personale

➤ Mbikëqyrje dhe inspektime.

Nëpërmjet procedurave për realizimin e këtij produkti do të bëhet e mundur minimizimi i rrezikut të cënimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale; Ndërgjegjësimi dhe disiplinimi i kontrolluesve; Krijimi i praktikës së mirë për kontrolluesit.

➤ Ankesa të trajtuara

Trajtimi në kohë i ankesave të ardhura nga subjektet e të dhënave personale, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale. Për zgjidhjen dhe trajtimin e ankesave ndiqen hapa procedurale si kontaktimi i vazhdueshëm me subjektin mbi paraqitjen e provave, kërkesë informacioni paraprake nga kontrolluesi, seanca dëgjimore të zhvilluara deri në zgjidhjen përfundimtare dhe vendimet e dhëna, duke rritur në këtë mënyrë kontrollin mbi veprimtarinë e kontrolluesve publik e privat

Për Zyrën e Komisionerit është miratuar vetëm një program buxhetor, buxheti i së cilës konsiston në mbështetjen logjistike të ushtrimit të kompetencave e funksioneve të zyrës, në drejtim të monitorimit të ligjeve respektive, për arritjen e objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Me ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2021”, fondet e akorduara gjatë vitit për funksionimin e aktivitetit të Zyrës së Komisionerit janë në total në vlerën 78.000 (në mijë lekë), me paraqitjen strukturore të mëposhtme:

Nr.	EMËRTIMI	PLANI BUXHETOR 2021, i ndryshuar (në mijë lekë)
1	Paga	42.726
2	Sigurime shoqërore	7.300
3	Mallra e shërbime të tjera	15.074
4	Llog 231 Investime	1.000
a)	Blerje pajisje zyre/kompjuterike/elektronike/vegla e pajisje/18AD102	
5	Transferta te buxhetet familjare	500
6	Kuotizacion	100
	Fondi i vecantë	200
	Totali	66.700

Ndërsa vlera e mbartur sipas artikujve buxhetore, paraqitet për sa e si më poshtë:

- 1- Shpenzime operative në vlerën 9.271.435 lekë
- 2- Shpenzime kapitale në vlerën 29.146.551 lekë

Ndërkohë, nga kontributi i donatorëve të krijuar gjatë vitit 2019-2020 për vlerat e mësipërme, Zyra e Komisionerit arriti të mbulojë financimin e disa aktiviteteve si dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së institucionit, duke realizuar në këtë mënyrë performancë në rritje të treguesve dhe indikatorëve të parashikuar edhe në strategji të veçanta ndërinstitucionale në të cilat Zyra e Komisionerit është pjesë.

1. Realizimi i Treguesve ekonomiko-financiare

Zyra e Komisionerit ka ngritur sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili është mbështetur në Ligjin nr.10296, datë 8.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar si dhe në parimet e menaxhimit të fondeve publike me efektivitetet, transparencë, ekonomi dhe eficensë.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor me ndryshimet gjatë vitit, u shpenzuan 64.058 (në mijë lekë). Buxheti në tërësinë e tij u realizua në masën 96%, kundrejt planit vjetor 2021. Tabela pasqyron realizimin në vlerë dhe në përqindje për çdo kategori shpenzimesh përkundrejt totalit të buxhetit të akorduar.

REALIZIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2021

Nr.	EMËRTIMI	000 / lekë		000/lekë	
		PLAN	PËRQINDJE KUNDREJT TOTALIT	FAKT 12 MUJOR	PËRQINDJE REALIZIMI KUNDREJT PLANIT VJETOR
1	Paga	42.726	64 %	42.142	98.6 %
2	Sigurime shoqërore	7.300	11 %	6.987	95.7 %
3	Mallra e shërbime të tjera	15.074	22.6 %	13.491	89 %
4	Investime	1.000	1.5 %	995	99.5 %
5	Transferta te buxhetet familjare	500	0.8 %	369	74 %
6	Kuotizacion	100	0.1%	74	74 %
	Totali	66.700	100%	64.058	96 %

○ **Fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore.**

Siç shihet nga pasqyra, pjesën kryesore të shpenzimeve e zënë pagat e personelit, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Fondi i përgjithshëm i pagave është realizuar për numrin faktik të punonjësve (38) përkundrejt 44 punonjës të miratuar, si dhe punonjësve jashtë strukturës, në vlerën 42.142 (në mijë lekë) ose 98.6 %. Për sa i përket kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore është realizuar në vlerën 6.987 (në mijë lekë) ose 95.7% e planifikimit.

Mosrealizimet në këtë zë kanë ardhur si pasojë e nisjes me vonesë të rekrutimeve dhe emërimeve në pozicionet e rregullta, për shkak të situatës zgjedhore dhe parashikimeve në kodin zgjedhor (pezullimi i përkohshëm i procedurave të rekrutimeve të reja) apo edhe të lëvizjeve për periudhën deri 4 muaj përpara procesit zgjedhor. Kjo ka sjellë që numri i punonjësve i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 84/2020 “Për disa shtesa e ndryshime të Vendimit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, reflektuar edhe në Ligjin e Buxhetit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, prej 44 punonjësish, të mbetet i paplotësuar. Ristrukturimi dhe funksionimi i strukturës së re krijoi pozicione të lira pune të nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues, për të cilën u hartua plani vjetor i rekrutimit për vitin 2021, i cili gjatë vitit pësoi ndryshime, për shkak të krijimit

të vendeve të reja vakante të lira, si rezultat i dorëheqjeve/largimeve dhe rezultateve të procedurave të rekrutimit.

Gjithashtu, për shkaqe të arsyeshme dhe ligjore ka patur largime nga institucioni, për tu punësuar në institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, çka ka sjellë edhe largime me pezullim nga shërbimi civil (sipas parashikimeve të LNC).

Gjithashtu kjo situatë është bërë me dije Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ku është raportuar mbi pozicionet e lira, ecurinë dhe problematikat e hasura në këtë proces dhe arsyet e mosplotësimit të strukturës deri në dhjetor 2021.

Është punuar për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të Zyrës së Komisionerit, nëpërmjet trajnimeve të ASPA, të ndjekura nëpërmjet platformave online.

Referuar përmirësimit të funksionit organizativ e institucional të Zyrës së Komisionerit dhe objektivave të vendosura për vitin 2021, si dhe rrethanave të reja, të krijuara nga situata e pandemisë, si çdo fillim viti në bashkëpunim edhe me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike është kryer analiza e nevojave për trajnim ku më pas është hartuar edhe një kalendar i trajnimeve duke mundësuar njohjen me standardet dhe praktikat më të mira trajnuese për administratën publike. Pjesëmarrës në këto trajnime kane qenë rreth 20 punonjës të institucionit, të cilët morën pjesë në 28 trajnime, kryesisht online për 15 tematika të ndryshme.

- **Fondi për Shpenzime Korente të tjera (602-606)**, për periudhën Janar-Dhjetor 2021, është realizuar në vlerën **13934** perkundrejt planit vjetor 15.674 (në mijë lekë) rreth 89 % e fondit të planifikuar vjetor për vitin 2021 të këtij shpenzimi (602-606), kryesisht për shpenzimet e domosdoshme të planifikuara, të miratuara apo dhe të rishikuara kanë gjetur realizim, sipas nevojave konkrete të institucionit

Ky fond është realizuar për:

- Shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit, si detyrime energji elektrike, ujë, shërbime bankare, postare e telefonike.
- Shpenzime në funksion të realizimit të qëllimit të Komisionerit, sigurimit të standarteve gjate ushtrimit të veprimtarisë, në zbatimin e ligjeve bazë, nëpërmjet mbikëqyrjes së zbatimit të tyre në institucionet e administratës publike si dhe kontrolluesit publikë e privatë.
- Shpenzime për shtimin e masave higjieno-saniatare, nëpërmjet sigurimit të materialeve për parandalimin e covid-19
- Shpenzime të tjera mirëmbajtjes/furnizime, të tjera shërbime bazë.
- Shpenzime të sigurimit të godinës/ mjeteve etj
- Shpenzime për platformat online te takimeve

Mosrealizimet në këtë zë kanë ardhur si pasojë e pezullimit tërësisht të aktiviteteve jashtë vendit apo edhe inspektimeve në terren (kufizuar vetëm në Tiranë dhe jo jashtë saj), si pasojë e vijimit të situatës së krijuar nga përhapja e covid-19, por edhe procesit të ristrukturimit dhe mungesës së stafit etj etj, të detajuara si arsyetime më gjerësisht edhe në këtë raportim. me Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 3.12.2021 Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, fondet e vitit 2021 u reduktuan në masën 11.500 (në mijë lekë), në masën 8.500 (në mijë lekë) në kategorinë e shpenzimit “Shpenzimeve të personelit dhe të lidhura me to” si dhe në masën 3.000 (në mijë lekë) në kategorinë “Shpenzimeve operative”, si fonde të papërdorura, duke i kaluar në fondet e buxhetit të shtetit.

Ndërsa vlera e mbartur sipas artikujve buxhetore dhe vlera e përdorimit paraqitet si më poshtë:

- 1- Shpenzime operative plani në vlerën 9.271.435 lekë , ndërsa është realizuar 1.125.953 lekë
- 2- Shpenzime kapitale plani në vlerën 29.146.551 lekë, ndërsa është realizuar 4.723.680 lekë
 - o **Fondi për shpenzime investime (zëri 231)**, ku vlera e planit vjetor të fondit të investimeve është 1.000 (në mijë) lekë.

Në zbatim të planit për investime, Zyra e Komisionerit ka hartuar planin e prokurimeve, i cili për vitin 2021, nëpërmjet prokurimeve me vlerë të vogla, realizuar sa më poshtë:

- “Blerje Pajisje kompjuterike”, për sigurimin e pajisjeve IT, është realizuar në vlerën 866 (në mijë) lekë
- “Blerje Pajisje mobilerie”, për sigurimin e pajisjeve të mobilerise është realizuar në vlerën 65 (në mijë) lekë
- “Blerje Pajisje kondicionimi”, për sigurimin e pajisjeve për krijimin e kushteve të dhomës së serverave është realizuar në vlerën 64 (në mijë) lekë

Pra sikundër referohet realizimi fondi per investime është i realizuar plotësisht në masën gati 99.5 %.

Në Aneksin nr. 3 është paraqitur realizimi i treguesve të performancës/produkteve (në sasi dhe vlerë) në zbatim të objektivave për vitin 2021

Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, është kryer nëpërmjet monitorimit të elementëve të ndryshëm të ligjit si p.sh. numri i autoriteteve publike që kanë hartuar programet e transparencës, koordinatore të caktuar nga autoritetet publike, përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, numri i ankesave të shqyrtuara, hetimet e kryera, seanca dëgjimore të zhvilluara si dhe vendimet e dhëna. Produktet kryesore janë:

Nënprodukti A: Trajtim i ankesave brenda afateve (kthim përgjigje/inspektime/ vendime, kryesisht në bazë të ankesave (i ndryshuar), rreth 700+-)

Gjatë vitit 2021, Zyra e Komisionerit ka vijuar me monitorimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, duke shqyrtuar jo vetëm ankesat e depozituara, por duke kryer gjithashtu inspektive, seanca dëgjimore si dhe duke marrë vendime urdhërimi apo sanksionimi sipas ligjit për rastet kur është konstatuar refuzim i padrejtë i vënies në dispozicion të informacionit.

Për periudhën e raportimit Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit ka administruar 992 ankesa nga qytetarë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe gazetarë investigative si dhe u vijua me shqyrtimin e 44 ankesave të mbartura nga viti 2020, duke e çuar në 1036 në total, numrin e ankesa të shqyrtuara gjatë këtij viti.

Nga totali prej 1036 ankesash, për 698 prej tyre është vënë në dispozicion të ankuesit informacioni/dokumentacioni i kërkuar gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ. Ndërkaq 158 ankesa kanë rezultuar jashtë objektivit, 33 jashtë afatit, 36 të paplota, 19 të refuzuar bazuar në kufizimet e së drejtës për informim në përputhje me nenin 17 të ligjit për të drejtën e informimit dhe 2 ankesa janë pezulluar. 49 ankesa janë mbartur për shqyrtim në vitin 2022.

Me synim verifikimin e ankesave të depozituara, si dhe ndjekjen të procedurave të mëtejshme të shqyrtimit administrativ janë zhvilluar 23 inspektime pranë autoriteteve publike dhe 52 seanca dëgjimore. Në përfundim, Komisioneri është shprehur me 41 vendime, prej të cilave 36 vendime urdhërimi për dhënie informacioni, 1 vendim rrëzimi, 2 vendime mospranimi dhe 2 vendime me sanksion administrative gjobë

Në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Zyra e Komisionerit ka vijuar punën për mbikëqyrjen dhe garantimin e të drejtës për akses në informacion publik, duke u mbështetur në vendosjen e balancës dhe respektimin e parimit të proporcionalitetit.

Ky është një tregues cilësor i veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit, ku qytetari merr atë çfarë kërkon dhe i nevojitet.

Në tërësi Nënprodukti A: 1036+ 23 (ankesa+ inspektime) realizuar mbi 100 % të pritshmërisë

Nënprodukti B- Monitorim i Autoriteteve Publike me programe dhe transparencë të plotë (300+-monitorime) .

Zyra e Komisionerit e ka të përditësuar listën e autoriteteve publike, e cila pas ndryshimeve, për shkak të reformës së riorganizimit strukturor të organeve dhe institucioneve të administratës shtetërore, ku rezultojnë **374 autoritete publike**.

Ligji për të drejtën e informimit garanton transparencën proaktive dhe nxit integritetin, llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve publike. Një prej instrumenteve kryesorë që kontribuon në këtë drejtim, është programi i transparencës.

Si rezultat i monitorimeve të vazhdueshme, dhe aktiviteteve të tjera trajnuese/inspektuese nga Zyra e Komisionerit, gjatë këtij viti, vërehet një përmirësim, si në shtimin e numrit të autoriteteve të cilat kanë publikuar programin e transparencës, ashtu edhe në informacionin e publikuar në rubrikat e përfshira në këtë program.

Gjatë vitit 2021, janë monitoruar online plotësisht (374) autoritete publike nga të cilat 313 autoritete publike qendrore dhe të varësisë dhe 61 NjVV.

Autoritetet publike qendrore dhe të varësisë u monitoruan në lidhje me publikimin e “Programit të Transparencës të Rishikuar” sipas Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 për të cilin u la si afat data 30 qershor 2021 për miratimin dhe publikimin në faqet e tyre zyrtare.

Ndërsa 61 NJQV u monitoruan në lidhje me publikimin e “*Programit Model të Transparencës për NJVV*” sipas Urdhrit nr. 211 datë 10.09.2018.

Të gjitha autoritetet publike u monitoruan gjithashtu dhe për caktimin dhe publikimin e të dhënave të koordinatorit për të drejtën e informimit dhe publikimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve sipas Urdhrit nr.188 datë 18.12.2020.

Zbatimi i detyrimit për publikimin e programit të transparencës, të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe përditësimin të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve është në trend rritës

Nënprodukti B: Nga 300 (i ndryshuar) monitorime të AP, janë monitoruar 374 AP. Është një tregues, i cili është realizuar rreth 100 %, krahasuar me pritshmëritë, duke mos përfshirë numrin e rekomandimeve apo inspektimeve.

➤ **Të tjera aktivitete në funksion të rritjes së transparencës**

❖ **Kërkesa nëpërmjet regjistrit**

- Me VKM nr. 145/2018, u miratua krijimi i një Regjistri qendror të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit, i cili është një sistem të dhënash që i ofron mundësinë çdo qytetari, të dërgojë në mënyrë elektronike kërkesat për informacion pranë autoriteteve publike, si dhe ankesat pranë Zyrës së Komisionerit në rast refuzimi të dhënies së informacionit. REKPDI, garanton monitorimin në kohë reale të depozitimit dhe trajtimit të kërkesave/ankesave për informacion/dokumentacion publik.

Duke parë ecurinë e ngadaltë të instalimit të REKPDI përgjatë këtyre viteve si dhe domosdoshmërinë për zhvillimin dhe shtrirjen e tij, Zyra e Komisionerit realizoi instalimin e tij me fondet e veta buxhetore edhe për 24 autoritete të tjera publike duke e çuar në 95 numrin total të autoriteteve publike që e kanë funksional atë (krahasuar me periudhen 8-mujore ku është raportuar 71 AP . **Për vitin 2021**, numri i kërkesave për informacion publik të trajtuara nëpërmjet këtij Regjistri, nga 95 autoritete publike, është 382, ndërsa numri i ankesave është 49.

Në zbatim të Ligjit për të drejtën e informimit, si dhe rekomandimit të Rezolutës së Kuvendit, Zyra e Komisionerit ka realizuar publikimin në portalin e-Albania të shërbimeve “*Kërkesë për informacion publik*” dhe “*Ankesa për refuzim dhënie informacioni publik*” dhe aktualisht, këto shërbime janë funksionale për 61 autoritete publike, të cilët tashmë përdorin në sistemin backend AMS. Është parashikuar që ky sistem të jetë funksional për 100 autoritete publike deri në fund të 2021, ndërsa funksionimi i tij do të vijojë të shtrihet në më shumë institucione publike gjatë 2022.

Aktivitete të tjera mbështetëse.

Zyra e Komisionerit, si një institucion i cili ka në fokus nxitjen e transparencës dhe llogaridhënien e autoriteteve publike është pjesë e:

- ✓ Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015-2022 dhe Plani i ri i aktiviteteve 2018-2022
- ✓ Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit 2020-2023

- ✓ Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023 dhe Plani i Veprimit 2019–2023
- ✓ Strategjia për “Mirëqeverisjen”
- ✓ Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2018-2021

Në kuadër të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile gjatë vitit 2021 u realizuan disa aktivitete me fokus forcimin e të drejtës për informim. Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar me shoqatën Instituti për Drejtësi dhe Ndërmjetësim (IDM) për të trajnuar organizatat e shoqërisë civile lokale, për të monitoruar Programet e Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

- **Nënprodukti C: Mbikëqyrje dhe inspektime, i ndryshuar, (Inspektime mbi bazë ankese dhe kryesisht +- 40)**

Gjatë vitit 2021 u realizuan 46 hetime administrative. Nga këto, 12 janë iniciuar mbi bazë të ankesave dhe 34 me nismën e institucionit. 33 hetime administrative janë realizuar në kontrollues publik dhe 13 në kontrollues privat. Të gjitha këto hetime administrative, pavarësisht vështirësive që ka paraqitur situata e krijuar nga pandemia, janë realizuar në terren dhe pranë ambienteve të kontrolluesve, duke bërë të mundur realizimin e hetimeve administrative në mënyrë më të plotë në kuadër të verifikimit të të gjitha provave dhe situatës faktike në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

Gjatë ushtrimit të hetimeve administrative në sektorë të ndryshëm janë konstatuar problematika në drejtim të respektimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë kuadër, Komisioneri është shpreh me rekomandime unifikuese, në përmbushje edhe të detyrimeve të Rezolutës së Kuvendit.

- ***Rekomandime/Vendime gjore***

Komisioneri në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar, është shprehur me:

- **42 Rekomandime** në kontrollues publik dhe privat;
- **12 vendime me gjore** në kontrollues publik dhe privat, të cilat korrespondojnë me 31 sanksione administrative.
- **1 urdhër** për fshirjen e menjëhershme të imazhit.

Gjatë ushtrimit të hetimeve administrative në këtë sektor ka konstatuar problematika në drejtim të respektimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë kuadër, në përfundim, Komisioneri u shpreh me një rekomandim unifikues në sektorin e shëndetësisë mbi respektimin e detyrimeve ligjore, në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale dhe sensitive,

dërguar 15 institucioneve të kujdesit shëndetësor, në përmbushje edhe të detyrimeve të Rezolutës së Kuvendit.

Komisioneri ka dalë me 1 Vendim për lejimin e transferimit ndërkombëtar në shtete pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

Kontrolluesit janë të detyruar të njoftojnë Zyrën e Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale për të cilat ata janë përgjegjës.

Në përmbushje të detyrimit ligjor të kontrolluesve për të njoftuar për përpunimin e të dhënave personale, gjatë këtij viti, në regjistrin përkatës u shtuan 76 subjekte të reja. Numri i përgjithshëm i njoftimeve të përpunimit nga kontrolluesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, është **5818**.

Nënprodukti C: (Inspektime mbi bazë ankese dhe kryesisht +- 40) pa përfshirë veprime të tjera vendime, rekomandime, sanksione, urdhërime është realizuar nga ana sasiore **46 mbikqyrje** ose mbi 100 %, krahasuar me pritshmëritë

-Nënprodukti D. Ankesa të trajtuara (nr.rreth +- 250,)

Gjatë vitit 2021, pranë Zyrës së Komisionerit u administruan 362 ankesa, një shifër më e lartë se një vit më parë (308) , e cila tregon një rritje të ndërgjegjësimit të qytetarëve në cilësinë e subjektit të të dhënave në lidhje me ushtrimin e të drejtave që garanton ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, ndër të tjera, të drejtës për t'u ankuar. Në trajtimin e tyre, synimi kryesor ishte ndërgjegjësimi i kontrolluesve dhe përpunuesve për domosdoshmërinë e përmbushjes së detyrimeve që parashikon ligji për mbrojtje e të dhënave personale dhe rrjedhimisht garantimi i mbrojtjes së të drejtave të qytetarit.

Nënprodukti D: Ankesa të trajtuara, pa përfshirë vendime, rekomandime është realizuar nga ana sasiore 362 ankesa. Nga sa shihet janë realizuar 100 % e pritshmërive, i cili tregon ndërgjegjësimin e subjekteve si dhe vënien në vend të së drejtës/cënimit të privatësisë .

❖ Aktivitetet të tjera mbështetëse.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale po asistohet prej vitit 2020, nga Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis* e BE. Objektivi kryesor i projektit të binjakëzimit, ishte mbështetja e Zyrës së Komisionerit në përafrimin e legjislacionit kombëtar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis* të BE në këtë fushë. Njëkohësisht, forcimi i kapaciteteve institucionale të autoritetit lidhur me mbikëqyrjen dhe monitorimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative të institucioneve shqiptare për të zbatuar këto *acquis*.

Edhe pse projekti i binjakëzimit u zhvillua në rrethana të kushtëzuara nga pandemia, zbatimit i tij në formatin online, pati edhe avantazhe në shkëmbimin e eksperiencave dhe njohurive të përthithura, duke qenë se, përveç ekspertëve të huaj të përfshirë në zbatimin e projektit, rreth 63 të ftuar si lektorë të fushave të ndryshme, u përfshinë në trajnimet dhe aktivitetet e zhvilluara. Projektit të Binjakëzimit u permbyll në 12 dhjetor 2021, ku Zyra e Komisionerit dhe Bashkimi Evropian zhvilluan Ceremoninë e Mbylljes së tij. Projekti i Binjakëzimit luajti një rol shumë të rëndësishëm, jo vetëm në forcimin e kapaciteteve institucionale të Zyrës së Komisionerit për mbikëqyrjen dhe monitorimin e mbrojtjes së të dhënave personale si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, por edhe në rrafshet tjera.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka bashkëvepruar me organizatat e shoqërisë civile që nxitin dhe forcojnë zbatimin e të drejtave të qytetarëve. Një ndër këto raste është edhe mbështetja për organizatën Roma Veritas Albania, në kuadër të projektit të saj “*Edukimi ligjor i studentëve rom, mediatorëve komunitar dhe të shëndetit për të lehtësuar aksesin në drejtësi për komunitetin e tyre*”. Ky bashkëpunim është fokusuar në zhvillimin e trajnimit me studentë dhe pjesëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian, për njohjen me të drejtat kushtetuese të aksesit në informacionin me karakter publik dhe atë të mbrojtjes së privatësisë e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit prej vitit 2020 ka nisur një projekt ndërgjegjësues, i bashkërenduar dhe koordinuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, fushatë kombëtare “Edukimi digjital, luaj dhe mëso – Happy onlife”, i cili u finalizua me takime në 32 shkolla (për vitin 2021) Nëpërmjet kësaj loje u synua aftësimi i grup moshës 12-15 vjeç për sjelljet që duhet të përshtatin në rrjetet sociale dhe në përgjithësi, në mjedisin digjital.

Zyra e Komisionerit është e angazhuar vazhdimisht në nisma ndërgjegjëse apo edukuese, si në sferën publike ashtu edhe me subjekte private, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien në respektimin e të drejtave të qytetarëve.

Një tjetër aktivitet që mbështet të dy shtyllat për garantimin e dy të drejtave **është Shërbimi ligjor**, edhe pse në vitet e kaluara janë trajtuar si produkt më vete.

❖ *Hartimin e projekt akteve*

Në kuadër të përafrimit të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Bashkimit Evropian 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën e Policisë 2016/680 është bashkëpunuar me ekspertët e projektit të binjakëzimit që asistuan Zyrën e Komisionerit, mbi hartimin e projekt/ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Është hartuar paketa mbi projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” e cila përmban:

- Projektvendimin për propozimin e projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Relacionin shpjegues të projektligjit mbi analizën e detajuar të arsyeve që kanë çuar në propozimin e tij.
- Projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Tabelën e përputhshmërisë (TOC).
- Raportin e Vlerësimit të Ndikimit (RIA).

Është hartuar paketa mbi projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” , e cila përmban:

- Projektvendimi për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Relacionin shpjegues të projektligjit mbi analizën e detajuar të arsyeve që kanë çuar në propozimin e tij.
- Projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Raportin e Vlerësimit të Ndikimit (RIA).

Është hartuar draft/udhëzuesi “Për përpunimin e të dhënave personale në kuadër të zgjedhjeve”.

Janë analizuar dhe reflektuar mendimet ligjore dërguar nga Vodafone Albania dhe kompania IDRA research-consulting, mbi projektligjin “Për krijimin e regjistrit të komunikimeve tregtare të pakërkuar” .

❖ *Dhënie mendimi/opinione ligjore*

Zyra e Komisionerit është angazhuar në dhënien e mendimeve për projektaktet ligjore e nënligjore në raport me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Krahasimisht me një vit më parë, vërehet një ulje e numrit të akteve për të cilët është kërkuar opinion. Institucioni ka dhënë mendim për 22 projektakte, ndër to

projektligje, projektvendime dhe projekt marrëveshje. Gjithashtu, janë përgatitur 69 opinione ligjore të paraqitura për mendim nga kontrollues publik e privat.

❖ *Raportime*

- Është hartuar Raporti Vjetor 2020 mbi veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale drejtuar Kuvendit.
- Është hartuar raporti mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga Zyra e Komisionerit, për autoritet publike.
- Është raportuar në kuadër të rekomandimeve të lëna nga Raporti i Shtetit i BE-së për Shqipërinë, për vitin 2020, për kapitujt si më poshtë.
 - o Kapitulli “Kriteri Politik”.
 - o Kapitulli 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media”.
 - o Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”.
 - o Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”.
 - o Kapitulli 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor” .
- Është raportuar mbi Planin e Masave për zbatimin e rekomandimeve të KE për Zyrën e Komisionerit.
- Është raportuar në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP).
- Është raportuar në kuadër të zbatimit të “Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur dhe të Planit të saj të Veprimit”.
- Është punuar, si institucion pjesë e grupit të punës, Tabela e Përputhshmërisë (TOC) mbi Direktivën e BE-së 2018/4849 “Mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit” në kuadër të përafrimit të saj me Kodin Penal.
- Është plotësuar Pyetësi “Questionnaire on cross-border transfer mechanisms” në kuadër të GPA Policy Strategy Working Group.
- Është plotësuar Pyetësi “Access to data by government and public authorities for national and public security purposes”
- Raportime të tjera

❖ *Procese gjyqësore*

Gjatë vitit 2021, Zyra e Komisionerit ka ndjekur në total 34 procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë mbi zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Gjykata ka vendosur për 13 çështje rrëzimin e kërkesëpadsisë dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit, 2 pranimin e kërkesë padsisë, 4 pranim të pjesshëm të padsisë, 3 pushimin e gjykimit, 3 mos kompetencë tokësore, 1 kthyer për mangësi në kërkesë padi, ndërsa 8 çështje të tjera vijojnë të jenë në proces pranë kësaj gjykate.

Në total, gjatë këtij viti pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë ndjekur 8 procese gjyqësore sa i përket zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, prej të cilave 5 çështje për vendime të Komisionerit dhe 3 çështje e tjera, për

rastet për të cilat Zyra e Komisionerit nuk është shprehur me vendim, por pala paditëse ka vlerësuar ta thërrasë në cilësinë e të paditurit ose të palës së tretë.

Për sa më lart, për 2 çështje gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit, 6 të tjera vijojnë të jenë në proces gjyqësor.

Gjatë vitit 2021, Zyra e Komisionerit ka ndjekur procese gjyqësore edhe në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Numri total i çështjeve të regjistruara pranë kësaj gjykate në të cilat është palë Zyra e Komisionerit është 51, ndër të cilat, 49 vijojnë të jenë në proces, për 1 çështje gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë dhe për 1 çështje vendosi pranimin e kërkesë padisë.

❖ *Marrëdhëniet me Jashtë*

Në periudhën e raportimit, është siguruar dhënia e kontributit dhe pjesëmarrja aktive në 10 forume dhe rrjete ndërkombëtare të bashkëpunimit në fushat e së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

-Të ardhurat nga sanksionet/gjoha

Në fund të vitit 2021 u arkëtuan në total të ardhura nga sanksionet administrative për shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi në masën 2.337. 819 (në mijë lekë), sanksione të cilat arkëtohen në masën 100% në buxhetin e shtetit.

Sanksionet e vendosura vetëm për vitin 2021 janë në shumën 4.730 (në mijë lekë), nga ku vlera e arkëtuar ishte 1.820 (në mijë lekë). Nga ana tjetër, është arkëtuar edhe shuma 517 (në mijë lekë) për sanksione administrative që i përkasin periudhave të mëparshme (2015-2020).

KOMISIONERI

Besnik Dervishi